



Platforma CiviKos

Raporti i auditorit të pavarur dhe pasqyrat financiare individuale
Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2021

PËRMBAJTJA

FAQE

RAPORTI I AUDITORIT

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

1

PASQYRA E TË ARDHURAVE

2

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EQUITET

3

PASQYRA E RRJEDHJES SË PARASË

4

SHËNIMET E PASQYRAVE FINACIARE

5



RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Menaxhmentit të Platforma CiviKos

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare shoqëruese të Platforma CiviKos, që përfshinë Pasqyrën e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2021, Pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, Pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe Pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin që ka përfunduar, si dhe një përmbledhje të politikave të kontabilitetit dhe shënimeve tjera shpjeguese.

Sipas mendimit tonë pasqyrat financiare paraqesin drejtë, në të gjitha çështjet materiale pozicionin financiar të Platforma CiviKos më 31 Dhjetor 2021, dhe performancën e saj financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin që ka përfunduar në përputhshmëri me Ligjet aktuale në fuqi.

Baza për Opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në seksionin e raportit Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Organizata në përputhje me Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionistë (Kodit IESBA), dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tjera etike në përputhje me Kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe personave që janë të ngarkuar me qeverisjen e pasqyrave financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në pajtueshmëri me ligjet aktuale në fuqi dhe për kontrollet e brendshëm të cilat menaxhmenti i vlerëson të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësinë së organizatës për vazhdueshmërinë në të ardhmen, duke shpalosur, sipas nevojës, çështjet lidhur me vazhdueshmërinë në të ardhmen dhe përdorimit të parimit të vazhdueshmërisë së kontabilitetit përveç nëse menaxhmenti synon të likuadojë Organizatën apo të ndërpres operimin, apo nuk ka ndonjë alternativë tjetër të mundshme përveç se të bëjë atë.

Ata të cilët janë ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Organizatës.

Përgjegjësitë e Auditorit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë të lira nga gabimet materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të nxjerrë një raport të auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk ka garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të gjithmonë do të zbulojë gabime materiale kur ato ekzistojnë.

Gabimet mund të rrjedhin nga mashtrimet apo gabimet dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose në total, ato në mënyrë të arsyeshme mund të pritët të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizmin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e gabimeve materiale në pasqyrat financiare, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dizajnojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit të përshtatshme për këto rreziqe, dhe marrim dëshmi të auditimit të mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të gabimeve materiale që rezultojnë nga mashtrimi është më i lartë se atij që rrjedh nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrolleve të brendshme.
- I kuptojmë kontrollet e brendshme relevante për auditimin me qëllim të hartimit të procedurave të auditimit që janë të përshtatshme në rrethanat, por jo për qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të Organizatës.
- I vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjet relevante të bëra nga menaxhmenti.
- Konkludojmë mbi përshtatshmërinë e përdorimit të parimit të vazhdueshmërisë së kontabilitetit nga menaxhmenti, duke u bazuar në dëshmitë e siguruar të auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston në lidhje me ngjarjet apo kushteve që mund të hedhë dyshime të konsiderueshme mbi aftësinë e organizatës për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për shpalosjet relevante në pasqyrat financiare apo, nëse shpalosjet e tilla janë të papërshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë që organizata të pushojë së vazhduari në vijimësi.

Ne komunikojmë me ata të ngarkuar me qeverisje lidhur me, në mesin e çështjeve tjera, qasjen e planifikuar dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollet e brendshme që kemi identifikuar gjatë auditimit.





Armend Osaj – Auditor Ligjor
ACA – Audit & Consulting Associates
Prishtine, Kosovo
24 Mars 2022

Platforma Civikos
Pasqyra e Pozitës Financiare
Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2021

	Shënimi	31 Dhjetor 2021 (në EUR)	31 Dhjetor 2020 (në EUR)
Asetet			
Asetet qarkulluese			
Paraja dhe ekuivalentet e parasë	3	128,823	24,119
Llogaritë e arkëtueshme	4	-	5,630
Të arkëtueshmet tjera		557	-
Total asetet qarkulluese		129,380	29,749
Asetet jo-qarkulluese			
Prona, impiantet dhe pajisjet	5	-	-
Totali i aseteve jo-qarkulluese		-	-
TOTAL ASETET		129,380	29,749
DETYRIMET DHE EKUITETI			
Detyrimet rrjedhëse			
Obligimet tatimore	6	900	-
Të hyrat e shtyera	7	128,480	29,749
Totali i detyrimeve rrjedhëse		129,380	29,749
Detyrimet jo-rrjedhëse			
Totali i detyrimeve jo-rrjedhëse		-	-
Ekuiteti			
Kapitali		-	-
Mbetjet nga vitet e kaluara		-	-
Mbetjet nga viti aktual		-	-
Totali i ekutetit		-	-
TOTALI I DETYRIMEVE DHE EKUITETIT		129,380	29,749

Pasqyrat financiare janë nënshkruar në 24 Mars 2022 nga:

Donika Emini

Drejtoreshë Ekzekutive

Arzade Bllacaku Heta

Menaxhere Financiare

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri në 13 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

Platforma CiviKos
Pasqyra e të ardhurave
Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2021

		Fundi vitit 31 Dhjetor 2021 (në EUR)	Fundi vitit 31 Dhjetor 2020 (në EUR)
	Shënimi		
Të hyrat			
Të hyrat hyrat nga Grantet	8	120,219	77,763
Totali i të hyrave		120,219	77,763
Shpenzimet			
Shpenzimet e administratës	9	29,583	13,669
Shpenzimet programore	10	15,620	5,670
Pagat dhe benefitet	11	75,016	58,425
Total i shpenzimeve		120,219	77,763
Pjesa e mbetur		<u>-</u>	<u>-</u>

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri në 13 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

Platforma CiviKos
Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet
Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2021

	Mbetja	Totali i mbetjes
	(në EUR)	(në EUR)
Gjendja fillestare më 1 Janar , 2020	-	-
Mbetja e fundit të vitit më 31 Dhjetor 2020	-	-
Gjendja më 31 Dhjetor 2020	-	-
Mbetja e fundit të vitit më 31 Dhjetor 2021	-	-
Gjendja më 31 Dhjetor 2021	-	-

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri në 13 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

Platforma CiviKos
Shënimet e rrjedhës së parasë
Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2021

	Fundi vitit 31 Dhjetor 2021 (në EUR)	Fundi vitit 31 Dhjetor 2020 (në EUR)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operuese		
(Deficiti)/mbetja për periudhën	-	-
Rregulluar për:		
Zhvlerësimi	-	-
Ndryshimet në të arkëtueshme	5,630	(3,261)
Ndryshimet në të arkëtueshme tjera	(557)	-
Ndryshimet në detyrimet në tatimore	900	-
Ndryshimet në të hyra të shtyera	98,731	25,593
Paraja neto nga aktivitetet operuese	104,704	22,332
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese		
Blerja e pronës dhe e paisjeve	-	-
Paraja neto e përdorur në investime		
Ndryshimet neto në para dhe ekuivalent	104,704	22,332
Paraja dhe ekuivalentet e parasë më 1 Janar	24,119	1,788
Paraja dhe ekuivalentet më 31 Dhjetor	128,823	24,119

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri në 13 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

1. HYRJE

Platforma CIVIKOS është një nismë e organizatave të shoqërisë civile në Kosovë e ka filluar në fillim të vitit 2007 dhe është regjistruar zyrtarisht më 2 shtator 2007, për qëllim krijimin e një mjedisi të përshtatshëm për bashkëpunim e sektorit zyrtar të shoqërisë civile dhe Qeverisë së Kosovës .

Mbështetur nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur , me pjesëmarrjen e shumë anëtarëve të CSO dhe zyrtarëve të qeverisë , kjo iniciativë u lançua zyrtarisht në korrik 2007 . Ndër të tjera , Platforma CIVIKOS , pas një procesi të gjatë të konsultimit me pjesëmarrjen e mbi 130 organizatave të shoqërisë civile , më 9 nëntor 2007 ka nënshkruar një Memorandum Bashkëpunimi në mes të Qeverisë së Kosovës dhe shoqërisë civile (e përfaqësuar nga Platforma CIVIKOS) . Ky memorandum përfaqëson dokumentin e parë zyrtar që ofron për një angazhim të ndërsjellë dhe bashkëpunimit institucional në partneritetet të mirëfilltë mes qeverisë dhe shoqërisë civile.

Pas një periudhe të aktiviteteve të kufizuara , gjatë muajit Maj 2010 Bordi i Platformës CIVIKOS vendosi të angazhohet në aktivitete shumë konkrete për të forcuar Platformën me qëllim promovimin e Memorandumit të Bashkëpunimit në një Strategji për bashkëpunim mes Qeverisë së Kosovës dhe të shoqërisë civile , i cili do të paraqiste një dokument bazë për kthimin e premtimeve të marra në veprimet dhe rezultatet konkrete .

Me këtë iniciativë , gjatë vitit 2010 dhe 2011 Platforma CIVIKOS u fokusua në forcimin e saj të brendshëm , ndër të tjera duke organizuar kuvendin e anëtarëve , konsolidimin e dokumenteve të saj për funksionalitetin me sukses të Platformës dhe gjithashtu duke zgjedhur struktura të reja udhëheqese dhe menaxheriale.

Platforma CIVIKOS ka qenë e angazhuar në inicimin e dialogut me Qeverinë e Kosovës drejt strukturimit të bashkëpunimit në mes shoqërisë civile dhe sektorit të qeverisë. Në këtë drejtim pengesa kryesore ishte vakumi institucional e krijuar në Kosovë në fund të vitit 2010 dhe fillim të vitit 2011, si pasojë e procesit të gjatë të zgjedhjeve dhe vonesa në krijimin e institucioneve qeveritare. Gjatë vitit 2011 janë organizuar takime të shumta me organizatat anëtare ku çështjet kryesore që u adresuan dhe diskutuan ishin mbi bashkëpunim me sektorin qeveritar. Rezultati kryesor që rrjedhi nga kjo fazë përgatitore është se Platforma CIVIKOS ka hartuar Kornizën e Strategjisë për bashkëpunim me Qeverinë e Kosovës, një dokument të brendshëm të Platformës e cila reflekton pozicionin e konsoliduar e anëtarëve të saj për komponentë të ndryshëm të këtij bashkëpunimi.

Gjatë këtyre dy viteve të fundit, Platforma CIVIKOS ka organizuar një numër të konsultimeve me organizatat e shoqërisë civile, kryesisht organizatat anëtare, jo vetëm për objektivat e strategjisë, por edhe kanë përgatitur një numër të analizave dhe studimeve për çështje të ndryshme të cilat do të inkorporohen në Strategjinë e bashkëpunimit, duke ofruar një bazë profesionale të informacionit dhe njohurive për të hartuar një dokument serioz për bashkëpunim.

Platforma CiviKos është duke u rritur në mënyrë të shpejtë, kjo reflekton edhe vullnetin e organizatave të reja për të qenë pjesë e CiviKos. Aktualisht, CiviKos numëron 282 organizata anëtare.

CiviKos së bashku me Zyrën për Qeverisje të Mirë/ Zyra e Kryeministrit udhëheqin procesin e bashkëpunimit në mes të shoqërisë civile dhe autoriteteve publike.

Këshilli për Bashkëpunim Shoqëri Civile - Qeveri është mekanizmi kryesor që koordinon procesin e bashkëpunimit të qeverisë me shoqërinë civile. Këshilli ka 29 anëtarë, 15 anëtarë janë nga shoqëria

Platforma CiviKos
Shënimet e pasqyrave financiare
Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2021

civile të zgjedhur në mënyrë demokratike nga vet organizatat e shoqërisë civile përmes Platforma CiviKos, dhe 14 anëtarë janë të emëruar drejtpërdrejt nga qeveria.

CiviKos ka vazhduar me aktivitetet në kuadër të aktivitetit të USAID Komunitet Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse, duke ofruar punëtori mbi mësimin e aplikueshëm në monitorim të prokurimit publik për organizata. Po ashtu gjatë vitit 2021 CiviKos ka ofruar shërbimin informues për organizata anëtare duke ndarë buletin javor për çdo javë.

2. BAZA E PËRGATITJES DHE POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL

2.1 Baza e përgatitjes

Pasqyrat financiare për Organizatën janë përgatitur në bazë të kontabilitetit në bazë akruale për të hyrat dhe shpenzimet. Bazat e matjes janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në politikat e kontabilitetit të paraqitura më poshtë.

2.2 Valuta e përdorur

Valuta funksionale e Organizatës është valuta e Bashkimit Evropian Euro ("EUR"). Pasqyrat financiare janë prezantuar në euro.

2.3 Shkëmbimi i valutës së huaj

Transaksionet në valutë të huaj janë shkëmbyer në monedhën funksionale duke përdorur kursin e këmbimit ekzistues në datat e transaksioneve. Fitimet dhe humbjet në valutat e huaja që rezultojnë nga rregullimet e transaksioneve të tilla si dhe nga ri-matjet e zërave monetar me kurset e këmbimit të fund vitit paraqiten si fitim ose humbje.

2.4 Të arkëtueshmet tregtare

Të arkëtueshmet tregatre fillimisht njihen me vlerën e drejtë dhe më pas mbarten me kosto minus provizionet, nëse ka. Një provizion njihet kur ka dëshmi objektive që Organizata nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha shumat e duhura sipas kushteve fillestare të të arkëtueshmeve. Shembuj të dëshmive objektive mund të jenë vështirësitë e mëdha financiare të klientit, probabiliteti i madh që klienti të falimentojë si dhe vonesat e vazhdueshme në pagesa.

2.5 Paraja dhe ekuivalentet e parasë

Për qëllime të pasqyrës së rrjedhës së parasë, paraja dhe ekuivalentët e parasë janë konsideruar të jenë paraja e gatshme si dhe ajo në llogari rrjedhëse, si dhe paraja me maturitet jo më shumë se tre muaj.

2.6 Të pagueshmet tregtare

Shumat e pagueshme janë matur në kosto që është vlera e drejtë e shumës për t'u paguar në të ardhmen për mallërat dhe shërbimet që janë marrë.

2.7 Tatimet

Organizata u themelua si një organizatë joqeveritare, për këtë arsye ka përgjegjësi dhe vepron si një OJQ sipas ligjeve në fuqi të Kosovës.

2.8 Njohja e të hyrave

Të hyrat nga grantet njihen si të ardhura në periudhën kur paguhen. Në fund të vitit sasia e tepërt e të ardhurave krahas shpenzimeve trajtohen si bilanc i bartur në periudhën e ardhshme.

2.9 Shpenzimet

Shpenzimet e ndodhura janë njohur në periudhën përkatëse në baza akruale.

2.10 Përfitimet e të punësuarve

Organizata, në rrjedhën normale, bën pagesa në buxhetin e shtetit për llogari të puntorëve. Puntorët e Organizatës janë anëtarë të planit shtetëror të pensioneve. Të gjitha kontributet e tilla në skemat e pensioneve të detyrueshme qeveritare shpenzohen kur ato ndodhin. Organizata nuk operon asnjë skemë tjetër pensioni ose plan përfitimesh pas daljes në pension dhe, rrjedhimisht, nuk ka asnjë detyrim në lidhje me pensionet.

Për më tepër, Organizata nuk ka detyrime materiale për të siguruar përfitime të mëtejshme për puntorët paraprak dhe aktual.

Platforma CiviKos
Shënimet e pasqyrave financiare
Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2021

3. PARAJA DHE EKVIVALENTET E PARASË

	31 Dhjetor 2021 (në EUR)	31 Dhjetor 2020 (në EUR)
Paraja e gatshme	131	143
Paraja në bankë	128,692	23,976
Totali parasë dhe gjendjes në bankë	128,823	24,119

4. TË ARKËTUESHMET

	31 Dhjetor 2021 (në EUR)	31 Dhjetor 2020 (në EUR)
Tjera	-	5,630
Total i të arkëtueshmeve	-	5,630

5. PRONA, IMPIANTET DHE PAJISJET

Organizata trajton blerjen e aseteve si shpenzime. Prandaj, ato nuk janë të kapitalizuara dhe nuk zhvlerësohen.

6. OBLIGIMET TATIMORE

Obligimet tatimore kanë të bëjnë me tatimin në burim ne paga, kontributet pensionale të pagave dhe tatimit I mbajtur ne burim per qira të dhjetorit, që do të paguhet gjatë vitit 2021.

	31 Dhjetor, 2021 (në EUR)	31 Dhjetor, 2020 (në EUR)
Tatimi i mbajtur në burim	349	-
Kontributi pensional	496	-
Tatimi ne qira	55	-
Totali i obligimeve tatimore	900	-

Platforma CiviKos
Shënimet e pasqyrave financiare
Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2021

7. TË HYRAT E SHTYERA

	31 Dhjetor, 2021 (në EUR)	31 Dhjetor, 2020 (në EUR)
UNDP	-	12,200
Anetaresia	8,578	1,043
BTD	57,212	-
NED	15,790	-
SlovakAid	3,069	-
Team Project	43,831	16,506
Totali i të hyrave të shtyera	128,480	29,749

8. TË HYRAT

	31 Dhjetor, 2021 (në EUR)	31 Dhjetor, 2020 (në EUR)
Të hyrat nga antarësia	135	-
ECNL	8,182	9,171
UNDP	7,800	-
KFOS	-	19,945
NED	20,432	-
SlovakAid	7,000	-
RFB NO 0307-327-1/20	895	-
CDF	9,818	-
BTD	62,074	-
DAI	102,615	48,647
Të hyrat e shtyera nga viti i kaluar	29,749	-
Të hyrat e shtyera	(128,480)	-
Totali i të hyrave	120,219	77,763

Platforma CiviKos
Shënimet e pasqyrave financiare
Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2021

9. SHPENZIMET ADMINISTRATIVE

	31 Dhjetor, 2021 (në EUR)	31 Dhjetor, 2020 (në EUR)
Komunikimi (interneti, telefoni)	48	546
Qeraja, Shërbimet Komunale	7,073	8,208
Shpenzimet e zyrës	124	1,112
Shpenzimet e veturës	157	487
Shpenzimet Bankare	670	398
Tjera	21,510	2,919
Totali i shpenzimeve administrative	29,583	13,669

10. SHPENZIMET PROGRAMORE

	31 Dhjetor, 2021 (në EUR)	31 Dhjetor, 2020 (në EUR)
Përkthimi	1,428	1,849
Printimi	-	409
Shpenzimet e Programit	14,192	3,354
Tjera	-	58
	-	-
Totali i shpenzimeve programore	15,620	5,670

Platforma CiviKos
Shënimet e pasqyrave financiare
Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2021

11. PAGAT DHE BENEFITET

	31 Dhjetor, 2021 (në EUR)	31 Dhjetor, 2020 (në EUR)
Pagat	75,016	58,425
Totali i pagave dhe i benefiteve	75,016	58,425

12. TOTALI I TË HYRAVE DHE SHPENZIMEVE SIPAS PROJEKTEVE

	NED	DAI TEAM	ECNL	UNDP	SlovakAid	CDF	BTB	RFB NO 0307- 327-1/20	Total
Të hyrat nga Grantet	4,642	75,293	8,182	12,597	3,931	9,818	4,861	895	120,219
Totali i të hyrave	4,642	75,293	8,182	12,597	3,931	9,818	4,861	895	120,219
Shpenzimet									
Shpenzimet Administrative	1,067	26,931	50	-	426	1,182	1,369	-	31,025
Shpenzimet programore		27,550	1,040	12,597	2,605	5,480	732	895	50,899
Shpenzimet e pagave	3,576	20,811	7,092	-	900	3,156	2,761	-	38,295
Mjetet e kthyer tek donatori		-	-	-	-	-	-	-	-
Totali i shpenzimeve	4,642	75,293	8,182	12,597	3,931	9,818	4,861	895	120,219
Fitimi / (Humbja) i periudhës	-	-	-	-	-	-	-	-	-

13. NGJARJET E MËPASME

COVID-19

Në kohën e përgatitjes së raportit të auditimit, organizata ka vazhduar operimet dhe ka qenë në gjendje t'i përmbushë obligimet, për këtë arsye raporti është përgatitë duke përdorur bazën e vijimësisë.